



## GRANTI PERFORMANCËS KOMUNALE FAKTE

**Granti i performancës** komunale është një mekanizëm i themeluar dhe bashkë-financuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) dhe Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC). Nga viti 2019, Suedia dhe Norvegjia janë pjesë e bashkëfinancimit të grantin e performancës komunale, grant i cili ofrohet së bashku me **projektin DEMOS** të Helvetas Swiss Intercooperation.

Granti i performancës komunale u ndahet komunave bazuar në performancën e tyre në fushat e përzgjedhura. Ai nxit komunat drejt përmirësimit të më tejshëm të performancës së tyre në fushat e **qeverisjes demokratike, menaxhimit komunal dhe ofrimit të shërbimeve komunale.**

Buxheti vjetor i **Grantit**  
të **performancës** komunale  
në vlerë rreth

**4.5**  
milion Euro

është në  
dispozicion  
për vitet  
**2020 - 2021**

Granti mund të  
përdoret vetëm për  
investime kapitale.

Të  
**38**  
komunat

e Kosovës gëzojnë  
të drejtën e  
pjesëmarrjes në këtë grant

### SI FUNKSIONON?

**Granti i performancës komunale bazohet në parimet, si vijon:**

- Komunat duhet, për çdo vit, të plotësojnë disa kritere minimale, përpara se të kualifikohen për Grantin e performancës komunale në baza vjetore;
- Për të gjitha komunat që kanë plotësuar kriteret minimale, shumica e grantit jepet në bazë të pikëve relative të arritura, e të cilat maten kundrejt 30 treguesve të performancës.

### QËLLIMI I GRANTIT TË PERFORMANCËS

Qëllimi i përgjithshëm i Grantit të Performancës komunale, i cili është plotësisht i integruar në sistemin e Kosovës, është të nxisë komunat drejt përmirësimit të proceseve të qeverisjes dhe shërbimeve më të mira për qytetarët.



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC



Sweden  
Sverige



Norwegian Embassy  
Prishtina